



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 312/5 prot.

Tiranë, më 7.8.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 768, datë 31.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Sonjela Voskopi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën 23.7.2024, është njoftuar vendimi nr. 768, datë 31.5.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Sonjela Voskopi, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 768, datë 31.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Sonjela Voskopi, aktualisht ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Sonjela Voskopi, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr.84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si AKSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (*në vijim referuar si KLGJ*), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Sonjela Voskopi*”,² ka referuar se:

- i Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 AKSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit raportin nr. *** prot., datë **.11.2017, për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, dhe ka konstatuar: “*Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Sonjela *** Voskopi*”³. Pas kërkesës së Komisionit për përditësim, AKSIK ka përcjellë raportin nr. ***, datë **.4.2024⁴, ku ka referuar se: [...] *Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Sonjela *** Voskopi, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit [...].*

2.3 KLGJ, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁵ për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Sonjela Voskopi.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë:** [...] *Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka deklaruar saktësisht e plotësisht në këtë deklaratë pasuritë e saj, personave të lidhur me të dhe personave të tjerë të lidhur, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës. Subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të*

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.3.2018.

³ Sqarojmë se ky raport është përpiluar pa përgjigjen e një prej 3 autoriteteve verifikuese, konkretisht Shërbimit Informativ të Shtetit.

⁴ Deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. ***, datë **.5.2024, të KDZH-së.

⁵ Raport i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. ***/* prot., datë **.2.2022.

deklaruar dhe nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të saj. Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].⁶

3.2 Për kontrollin e figurës: [...] duke mbajtur në konsideratë edhe nivelin, edhe integritetin profesional të bashkëjetuesit që rezulton nga provat e paraqitura prej subjektit në prapësime, çështjet penale të shqyrtuara gjatë hetimit nga Komisioni që rezultuan pa problematika, mungesën e kontakteve të papërshtatshme në kuptim të neneve 34, 38 e 39 të ligjit nr. 84/2016, nga ana e subjektit ose bashkëjetuesit të saj, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet për të aplikuar ndaj saj nenin 61, pikat 2 dhe 5 të këtij ligji. [...].⁷

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale: [...] trupi gjykues vlerëson se nuk janë konstatuar shkelje nga ana e subjektit të rivlerësimit, që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale dhe, sipas pikës 1, shkronjave “a” dhe “b” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016 [...].⁸

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenet D, DH dhe E të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të pikës 1/a, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash, ka vendosur:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Sonjela Voskopi, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë.

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

⁶ Referohuni në faqen 57, prg. 17 dhe 17.1, të vendimit të Komisionit.

⁷ Për më tepër referohuni në faqen 61, prg. 7.1, të vendimit të Komisionit.

⁸ Për më tepër referohuni në faqen 89, prg. 57, të vendimit të Komisionit.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

9. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 768/2024, në gjendjen që janë aktet në dosje, nuk krijohet bindja se provat kanë arritur nivelin e provueshmërisë, në drejtim të arritjes të nivelit të besueshmërisë për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

10. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik, në vlerësim tërësor të procedurave, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 768, datë 31.5.2024, të Komisionit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A - Lidhur me kontrollin e figurës

11. Nga aktet e administruara në dosje, rezulton se Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe ka përcjellë pranë Komisionit Raportin nr. *** prot., datë **.11.2017, për subjektin e rivlerësimit Sonjela Voskopi, të hartuar pa disponimin e përgjigjes të një prej organeve ligjzbatuese, konkretisht SHISH, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.

11.1 AKSIK, në vijim të informacioneve të ardhura nga autoritetet verifikuese në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë **.4.2024⁹, ka bërë me dije se: [...] *Për subjektin Sonjela Voskopi nuk disponohen të dhëna dhe nuk ka sinjalizime për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme. Informacionet/të dhënat e përcjella nga autoritetet verifikuese flasin vetëm për bashkëjetuesin e znj. Voskopi, ku informohemi se në cilësinë e avokatit, ai mund të ketë ushtruar ndikim të paligjshëm me qëllim favorizimin e të pandehurve. Gjithashtu, bëhemi me dije se autoritetet verifikuese kanë ndarë informacione të përditësuara me SPAK, ku e kanë përmendur bashkëjetuesin e znj. Voskopi ... Nga SPAK informohemi se për bashkëjetuesin e zonjës në fjalë ka një procedim penal, i cili është në fazën e hetimeve paraprake dhe nuk rezulton të ketë persona të regjistruar si persona nën hetim [...].*

11.1.1 Në përfundim, AKSIK ka referuar se: [...] *Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Sonjela Voskopi, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit [...].*

11.2 Nga aktet e administruara në dosje rezulton se Komisioni, në zbatim të nenit 50 të ligjit nr.84/2016, ka kryer veprime hetimore në drejtim të bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit dhe ka mbajtur korrespondencë me Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), që daton para administrimit të Raportit të përditësuar të AKSIK nr. *** prot., datë **.4.2024.

⁹ Deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. ***, datë **.5.2024, të KDZH-së.

11.2.1 Komisioni, përmes shkresës nr. *** prot., datë **2.2024, drejtuar SPAK, ka kërkuar që për shtetasin *** ***, **i datëlindjes **10.1948**, të vihen në dispozicion:

- *Kopje e plotë e fashikujve të procedimeve penale të hetuar, të mosfilluar, të pushuar apo të pezulluar nga kjo Prokurori;*
- *Çdo të dhënë apo indicie të ardhur nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së këtij shtetasi, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;*
- *Kopje të dokumentacionit që përmban të dhëna në rastet e dokumentuara të përfshirjes së këtij shtetasi në kontakte me persona të papërshtatshëm, ... ku përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.*

11.2.2 SPAK, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka përcjellë shkresën nr. ***/* prot. (***. ***), datë **2.2024, në të cilën ka informuar se, pas verifikimeve të kryera në Regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, nuk rezulton që në emër të **subjektit të rivlerësimit *** ***, i datëlindjes **10.1948**, të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

11.3 Gjithashtu, nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, rezulton se Komisioni para administrimit të Raportit të Përditësuar të AKSIK, ka mbajtur korrespondencë dhe me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë, të cilës i është drejtuar me shkresën nr. *** prot., datë **2.2024, kërkesë për informacion dhe dokumentacion, lidhur me 5 pesë çështje gjyqësore, të gjykuara në këtë gjykatë, konkretisht:

- 1- *Çështja penale e gjykuar në vitin 2020, me të pandehur shtetasit ***. ***, etj., të akuzuar për veprën penale “Shpërdorim detyre” dhe shtetasit ***. ***, dhe ***. ***.*
- 2- *Dosja për vlerësim mase të sigurimit personal ndaj të pandehurit ***. ***, akuzuar për veprën penale “Dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit”, si dhe nëse gjyqtarja Sonela Voskopi ka gjykuar çështje penale me të pandehur:*
- 3- ****. ***, datëlindja **2.1992 (Atësia ***, mëmësia ***);*
- 4- ****. ***, datëlindja **11.1982 (Atësia ***, mëmësia ***);*
- 5- ****. ***, datëlindja **3.1985 (Atësia ***, mëmësia ***).*

11.3.1 Në vijim, Komisioni, me shkresën nr.*** prot., datë **3.2024, ka kërkuar sërish pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë, që t’i vihen në dispozicion [...] kopje të fashikujve gjyqësorë për çështjet penale të gjykuara në gjykatën tuaj, për sa më poshtë:

- 1- *Çështja ndaj të pandehurit ***. ***, nr. ***-***-**-2021 sistemi, datë **1.2021 regjistrimi, nr.*** akti, me objekt “Vlerësim i masës së arrestit, caktim i masës së sigurimit”, etj., datë vendimi **10.2021.*
 - 2- *Çështja ndaj të pandehurit ***. ***, nr.***-***-**-2022 sistemi, datë **11.2022 regjistrimi, nr. *** akti, me objekt “Vlerësim i masës së arrestit, caktim i masës së sigurimit”, datë vendimi **11.2022.*
- *Në këta fashikuj të përfshihen edhe fashikujt e gjykimit të këtyre çështjeve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm [...].*

11.3.2 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me shkresën nr.***, datë **.3.2024, ka përcjellë në Komision kopjen e njësuar të dosjeve gjyqësore, si më poshtë:

- *Dosja Gjyqësore nr.*** prot., datë **.10.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me objekt: pyetje brenda tre ditëve, ndaj shtetasit ***. ***. dhe nëndosja me nr.*** regj., datë **.10.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë, ndaj shtetasit nën hetim ***. ***. etj.*
- *Dosja gjyqësore nr.*** regj., datë **.10.2021 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me objekt: vleftësimi arrest flagrancë, caktim mase sigurimi ndaj shtetasit ***. ***. etj.*
- *Dosja gjyqësore e Gjykatës së Apelit Korçë, me nr.*** vendimi, datë **.10.2021, ndaj shtetasit ***. ***.*

11.4 Komisioni, disa nga të dhënat e përfuara nga organet ligjzbatuese, i ka trajtuar në vendimin nr.768/2024, në kontrollin e vlerësimit të aftësive profesionale, në rastet e referuara në kapitullin “Konstatime të tjera”¹⁰, së bashku me çështje të tjera që kanë të bëjnë po me ushtrim ndikimi të paligjshëm dhe jo vetëm mbi subjektin e rivlerësimit, për të cilat Komisioni ka vlerësuar se rezervon të drejtën e ruajtjes së sekretit hetimor në mbështetje të vendimit të GJEDNJ-së, “Regner kundër Republikës Çeke”.

11.5 Referuar vendimit dhe rezultateve të hetimit¹¹, rezulton se Komisioni: [...] *nisur nga të dhënat e organeve ligjzbatuese në lidhje me veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetuesit të saj *** ***, ka administruar me shkresat nr.*** prot., datë **.3.2024 dhe nr.*** prot., datë **.3.2024, nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë, fashikujt e dosjeve gjyqësore për çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit ndaj disa shtetasve[...], nga të cilat, ka trajtuar sa më poshtë:*

12. (1) Çështja me objekt “Vlerësim i masës së arrestit dhe caktim mase sigurimi personal”, ndaj të ndaluarit * ***, i dyshuar për veprën penale “Ndihma për kalimin e paligjshëm të kufirit”**

12.1 Komisionit, ndër të tjera¹², i ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Korçë ka regjistruar procedimin penal nr.***, datë **.7.2020, në ngarkim të personit nën hetim *** ***. Në datën **.7.2020, ky shtetas është ndaluar dhe arrestuar në flagrancë nga patrulla e policisë, pasi drejtonte një autoveturë, me të cilën udhëtonin edhe 2 shtetas sirianë dhe 2 shtetas egjiptianë.

12.2 Nga kontrolli i automjetit, shtetasit *** *** i janë gjetur një dokument, që e identifikonte si punonjës informator i Agjencisë Investiguese “Stop krimin” dhe një shenjë dalluese “Policia e Shtetit”, që vendoset në uniformat e policisë. Gjithashtu, nga kontrolli i telefonit të këtij shtetasi u evidentuan video, ku ishte filmuar ky shtetas me shtetas të huaj në automjetin e tij, si dhe foto të faqes së parë të pasaportës së shtetasve të huaj. Këto foto e video i përkisnin muajve mars dhe maj të vitit 2020. Nga kontrolli i telefonave të shtetasve të huaj, nuk kanë rezultuar të dhëna me interes për hetimin.

¹⁰ Referohuni prg. 36 e vijues të vendimit të Komisionit.

¹¹ Referohuni prg. 54 të vendimit të Komisionit, si dhe prg. 169 të Rezultateve të hetimit, në dosje të Komisionit.

¹² Referohuni prg. 55 të vendimit të Komisionit, si dhe prg. 170 të Rezultateve të hetimit, në dosje të Komisionit.

12.3 Në datën **.7.2020, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Korçë ka përcjellë në gjykatë kërkesën për vlerësimin e ligjshmërisë së masës së arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal *“Arrest në burg”*, për shtetasin *** **.

12.4 Për gjykimin e kësaj kërkesë është caktuar subjekti i rivlerësimit, e cila, në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. **, datë **.7.2020, ka vendosur vlerësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit *** **, si dhe caktimin e masës së sigurimit *“Arrest në shtëpi”* ndaj këtij shtetasi, i mbrojtur nga avokati **. **. (i zgjedhur kryesisht nga gjykata).

12.5 Subjekti, referon Komisioni, në vendimmarrjen e saj ka përdorur argumente se duhen mbajtur parasysh disa rrethana: lloji i veprës penale që nuk është drejtuar ndaj shëndetit, jetës apo pasurisë së personit; fakti që ky shtetas nuk ka qenë i dënuar më parë dhe është familjar me dy fëmijë të mitur, 7 dhe 9 vjeç.

12.6 Për sa më lart, Komisioni ka arsyetuar: [...] *se duket se në veprimet e subjektit nuk ka veprime që e ngarkojnë atë me përgjegjësi [...]*.

13. (2) *“Zëvendësim i masës së sigurimit personal” ndaj shtetasve * **, *** **, *** **, *** **, *** **, *** **, dhe *** **, të ndaluar për veprën penale “Shpërdorim detyre”***

13.1 Komisionit, ndër të tjera¹³, i ka rezultuar se, me vendimin gjyqësor nr. **, datë **.12.2020, subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë ka caktuar ndaj shtetasve të ndaluar *** **, *** **, *** **, *** **, *** **, masën e sigurimit personal *“Arrest në burg”*, në përputhje me nenin 228 të K. Pr. Penale, duke argumentuar se ekziston rreziku që të dyshuarit të kryejnë të njëjtën veprë penale, si dhe duke mbajtur parasysh masën e dënimit për këtë veprë penale dhe rrethanat e kryerjes së kësaj vepre në mënyrë të vazhdueshme.

13.1.1 Për shtetasit *** ** dhe *** ** ka caktuar masën e sigurimit *“Pezullim i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”* të detyrës së punonjësit të policisë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, meqë këta e kanë kryer veprën penale vetëm në një episod të saj dhe jo në mënyrë të vazhdueshme.

13.2 Me provat e administruara deri në këtë fazë të hetimit kur Prokuroria ka kërkuar caktimin e masave të sigurimit, ka rezultuar se ka dyshime të arsyeshme që këta shtetas kanë kryer veprën penale *“Shpërdorim i detyrës”* (neni 248 i K. Penal), nëpërmjet favorizimit të transportimit të lëndës drusore pa dokumentacionin e nevojshëm në zonën e Maliqit në Korçë, duke i dhënë transportuesve informacionin se ku dhe kur ka patrulla policie, si dhe cilët policë janë në patrullë.

13.3 Subjekti i rivlerësimit, me qëllim verifikimin e kushteve dhe kriterëve të caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, në zbatim të nenit 248 të K. Pr. Penale, në datën **.12.2020, ka caktuar seancën gjyqësore të datës **.12.2020¹⁴. Në këtë seancë, të dyshuarit kërkuan zëvendësimin e masës së sigurimit *“Arrest në burg”* me masën *“Garanci pasurore”* dhe revokimin e masës *“Pezullim i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”*, meqenëse të

¹³ Referohuni prg. 56 të vendimit të Komisionit, si dhe prg. 175 të Rezultateve të hetimit, në dosje të Komisionit.

¹⁴ Neni 248, pika 1 i Kodit të Pr. Penale parashikon se: *“Jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës, Gjykata e merr në pyetje personin për të cilin nga vendosur arrestin në burg ose në shtëpi. Për masat e tjera të sigurimit shtrënguese ose ndaluese, gjykata procedon me marrjen në pyetje brenda pesë ditëve nga zbatimi i masës”*.

dyshuarit janë pezulluar prej punëdhënësit nga puna si policë për shkak të kësaj ngjarje. Të dyshuarit nuk paraqitën asnjë provë për të vërtetuar këtë fakt, i cili do të eliminonte shkakun për të cilin gjykata e kishte caktuar më parë këto masa sigurimi personal.

13.4 Në përfundim të gjykimit të kësaj kërkesë, me vendimin nr. ***, datë **.12.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*” për 5 shtetasit që kanë këtë masë. Gjykata ka argumentuar se kjo masë është caktuar, sepse ekziston rreziku që këta shtetas, duke qenë në detyrën e policit, mund të kryejnë të njëjtën veprë penale për të cilën dyshohen apo më të rëndë se ajo.

13.5 Në datën **.12.2020, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Korçë, janë regjistruar kërkesat e pesë shtetasve të përfaqësuar nga Av. *** ***, për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*” me masën “*Garanci pasurore në vlerën 300.000 lekë*”.

13.6 Në seancat gjyqësore të datës **.12.2020, subjekti i rivlerësimit, duke u bazuar në nenin 236 të K. Pr. Penale, me vendime individuale për secilin nga këta shtetas, ndër të tjera, ka vendosur: (i) Zëvendësimin e masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*” me masën “*Garanci pasurore*”, në vlerën 300.000 lekë; (ii) Caktimin edhe të masës shtrënguese “*Ndalim i daljes jashtë shtetit*”.

13.7 Në përfundim, Komisioni, ka arsyetuar që: [...] *duket se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe nuk konstatohen mangësi në veprimet e saj [...].*

14. Komisioni, në lidhje me konstatimet e grupit të punës në raportin e përcjellë nga AKSIK, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime të qarta dhe shteruese, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me ushtrim ndikimi të paligjshëm dhe jo vetëm.

14.1 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, lidhur me referimet e AKSIK, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Mbrojtja ime më e mirë në këtë rast është vetëhetimi shterues, i plotë dhe objektiv që Komisioni ka kryer. Së pari, edhe vetë AKSIK, me shkresën nr.*** prot., datë **.04.2024, drejtuar Komisionit, megjithëse përmend informacionin e përcjellë nga autoritetet verifikuese, se në cilësinë e avokatit **mund** të ketë ushtruar ndikim të paligjshëm me qëllim favorizimin e të pandehurve dhe këto informacione autoritetet verifikuese i kanë përcjellë në SPAK (pasi në shkresë tekstualisht shprehet: autoritetet verifikuese kanë ndarë informacione të përditësuara në SPAK), nga ana tjetër, ka thelluar hetimin, duke kërkuar informacion në SPAK, organi i cili ju ka bërë me dije se bashkëjetuesi im nuk është regjistruar si person nën hetim në ndonjë procedim penal. Së dyti, këtë verifikim e ka bërë edhe vetë Komisioni, duke kërkuar informacion të detajuar sipas shkresës nr.*** prot., datë **.02.2014¹⁵ dhe nga ana e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kthyer përgjigje me shkresën nr.***/* prot., datë **.02.2024, se nuk rezultoi që në emër të *** *** të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Kjo tregon se informacionet e përcjella nga autoritetet verifikuese kanë qenë të pabazuara, pasi i vetmi organ që, në bazë të nenit 75/a të K. Pr. Penale, ka në kompetencë hetimin e veprave penale të parashikuara nga nenet 245/1 dhe 244 të K. Penal, ka kthyer përgjigje se *** *** nuk është person nën hetim [...].*

¹⁵ Duket se duhet të jetë një lapsus, pasi shkresa mban numrin *** prot., datë **.2.2024.

14.2 Komisioni, në përfundim ka arsyetuar¹⁶ se: [...] duke mbajtur në konsideratë edhe nivelin, edhe integritetin profesional të bashkëjetuesit që rezulton nga provat e paraqitura prej subjektit në prapësime, çështjet penale të shqyrtuara gjatë hetimit nga Komisioni, që rezultuan pa problematika, mungesën e kontakteve të papërshtatshme në kuptim të neneve 34, 38 e 39 të ligjit nr. 84/2016 nga ana e subjektit ose bashkëjetuesit të saj, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet për të aplikuar ndaj saj nenin 61, pikat 2 dhe 5, të këtij ligji [...].

15. Komisioneri Publik, në gjendjen që janë aktet në dosje, nuk ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin, pasi konstaton se të dhënat e referuara në raportin e AKSIK-së dhe ato të trajtuara nga Komisioni në vendimin nr.768/2024, apo në rezultatet e hetimit, nuk referojnë të dhëna konkrete, më së paku, mbi arsyet e administrimit të dosjeve të kërkuara, si dhe dyshimet apo informacionet e administruara në funksion të tyre, në mënyrë që të vlerësohen nga Komisioneri Publik, nëse përmbajnë elemente të qenësishme që të cilësohen me ndikim në vlerësimin e kriterit për kontrollin figurës apo të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale.

15.1 Po ashtu, nga komunikimet e Komisionit me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë, duket se dosjet e administruara në funksion të informacioneve nga organet ligjzbatuese, janë disa, ndërkohë në vendim dhe në rezultatet e hetimit, duket se janë trajtuar vetëm dy prej tyre.

15.2 Nga dy çështjet e trajtuara, Komisioneri Publik, duke pasur mundësinë t'i referohet vetëm sa interpretuar në rezultatet e hetimit dhe sa pasqyruar nga Komisioni në vendimin nr. 768/2024, mund të konstatojë që në të dyja rastet e trajtuara, duket se nga subjekti i rivlerësimit është ndryshuar vlerësimi i masës së arrestit dhe caktimi i masës së sigurimit personal, por duke mos pasur mundësinë të vlerësojë mbi situatat dhe rrethanat konkrete të rasteve.

15.3 Në këto rrethana, në gjendjen që janë aktet në dosje, Komisioneri Publik, duke mos pasur vetë akses mbi informacionin e disponuar prej institucionit informues, për shkak të protokolleve të zbatuara nga ky institucion në lidhje me administrimin e informacionit të klasifikuar¹⁷, parashtron para Kolegjit nevojën për verifikimin në burim të përmbajtjes së këtyre informacioneve, trajtimin procedural të tyre, për sa kohë që raporti pjesërisht i deklasifikuar nuk jepte të dhëna që mund të analizoheshin dhe të mundësonin mbajtjen e një qëndrimi rreth këtij kriteri.

15.4 Po ashtu, Komisioneri Publik, lidhur me shkresën nr. *** prot., datë **.2.2024, drejtuar SPAK, me të cilën Komisioni ka hetuar lidhur me të dhënat që disponohen për bashkëjetuesin e subjektit të rivlerësimit, shkresë e cila referohet dhe nga subjekti i rivlerësimit në prapësimet e saj, duke e konsideruar shterues hetimin administrativ mbi këtë rrethanë, konstaton se gjeneralitetet mbi të cilat është bërë kërkimi janë *** ***, i datëlindjes **.10.1948. Mbi këto gjeneralitete është kthyer dhe përgjigjja e SPAK-ut, me nr. ***/* prot., datë **.2.2024, ndërkohë, nga aktet në dosje rezulton se datëlindja e saktë e bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit është **.4.1980.

¹⁶ Referohuni prg. 7.1, faqe 61 të vendimit të Komisionit.

¹⁷ Komisioneri Publik, në situata të ngjashme, nuk ka pasur akses mbi informacionin e disponuar prej institucionit informues, pavarësisht mundësisë së dhënë për këtë qëllim prej gjykatës. Referohuni këtu vendimit (JR) nr. 27/2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

15.4.1 Komisioneri Publik, duke konstatuar paraqitjen e gjeneraliteteve të ndryshme, si nga Komisioni, ashtu edhe në përgjigjen e SPAK-ut, në analogji dhe me jurisprudencën orientuese të Kolegjit, kur konstatohen shpresa me të dhëna kontradiktore¹⁸, vlerëson se, dhe në rastin konkret, ka nevojë të kryhen hetime më të thella, si edhe të evidentohet problematika e hasur në rrugë institucionale.

III.B - Lidhur me kontrollin e aftësive profesionale

16. Lidhur me konfliktin e interesit, trajtuar në vendim si “Konstatime të tjera”, së bashku me informacionet e organeve ligjzbatuese. Nisur nga të dhënat që Komisioni ka administruar gjatë hetimit, ka rezultuar se z. *** ***, që është bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit, është punësuar si kryetar i Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit Korçë, nga muaji janar i vitit 2014 deri gusht 2021. Nga hetimi administrativ ka rezultuar¹⁹ se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje me person të tretë, Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Korçë, si më poshtë:

16.1 (1) *Çështja civile me:* Palë paditëse – Shkolla e Mesme Profesionale “*** ***” Korçë; Të paditur, shtetasit ***, ***, ***, ***, Përmbaues Gjyqësor “***. – 2010”, Korçë; *Person i tretë* – Drejtoria Rajonale Arsimore Korçë (jo prezent) dhe *Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Korçë*; Objekti – Kundërshtim veprimesh përmbaresh etj. *Me vendimin nr.***, datë **.11.2016*, subjekti i rivlerësimit ka disponuar për kthimin e padisë dhe akteve bashkëlidhur te pala paditëse.

16.1.1 Komisioni ka vlerësuar se, pavarësisht që subjekti nuk ka gjykuar padinë në themel, për sa kohë që nëpërmjet kërkesëpadisë ka rënë në dijeni se Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Korçë është palë në këtë gjykim, si dhe është në dijeni për shkak të bashkëjetesës së saj, se Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Korçë drejtohet nga bashkëjetuesi i saj, *** ***, atëherë, në bazë të nenit 72, pika 3, të K. Pr. Civile, subjekti i rivlerësimit duhej që të hiqte dorë nga shqyrtimi i kësaj padie që në momentin kur është njohur me shortin e padisë dhe të mos kryente asnjë veprim procedural.

16.2 (2) *Çështja civile me :* Palë paditëse – ***, ***, Të paditur - Këshilli i Ministrave Tiranë, (në mungesë), dhe Bashkia Maliq (në mungesë), me *pjesëmarrjen Avokatura e Shtetit, Zyra vendore Korçë*, objekti – Detyrim njohje pronar me parashkrim fitues i tokës dhe ndërtesës me sip.71.71 m². Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë **.6.2020²⁰, ka vendosur pranimin e padisë.

16.3 Për sa më lart, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi duket se subjekti i rivlerësimit, duke mos hequr dorë nga gjykimi i padisë në dy çështjet më lart, ku është palë ndërgjyqëse Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Korçë, e drejtuar nga bashkëjetuesi i saj, ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit

¹⁸ Referohuni vendimit orientues (JR) nr.15/2019, prg. 98: [...] *Së bashku me këtë konkluzion, Kolegji, duke konstatuar paraqitjen e dokumentacionit me të dhëna të ndryshme nga i njëjti institucion shtetëror, në përgjigjet që institucionet u japin organeve të rivlerësimit dhe atyre që u japin subjekteve të rivlerësimit, si një problematike e hasur edhe në raste të tjera, bazuar në përcaktimet e nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, orienton Komisionin që në raste të ngjashme të kryejë hetime më të thella për të arritur në zbulimin e së vërtetës, si edhe të evidentojë problematikën e hasur në rrugë institucionale, për të shmangur përsëritjen e këtyre situatave në të ardhmen [...].*

¹⁹ Sipas shkresës nr.*, datë **.1.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë, dërguar Komisionit.

²⁰ Shkresa nr. ***, datë **.12.2023, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë, në përgjigje të shkresës nr. ***, datë **.12.2023, të Komisionit.

referuar nenit 3, pika 1, nenit 4, nenit 5, pika 1, “dh/i”, nenit 7 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

16.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka referuar se: [...] *Secili prej nesh ka marrë në kohë masa për të shmangur konfliktin e interesit në çdo rast që ai mund të krijohej. Unë në çdo rast që kam konstatuar se përfaqësues i Avokaturës së Shtetit në gjykim (si përfaqësues i interesave pasurore të shtetit dhe pjesëmarrës procedural sipas nenit 79/a të K. Pr. Civile), ka qenë bashkëjetuesi im, kam parashtruar para Kryetarit të Gjykatës kërkesë për heqje dorë. Bashkëngjitur, po Ju vë në dispozicion disa praktika për rastet kur në gjykimin në Shkallë të Parë ose në gjykimin në Apel, kur kjo e fundit gjykonte në juridiksion fillestar, ka qenë përfaqësues i Avokaturës së Shtetit bashkëjetuesi im dhe unë kam paraqitur para Kryetarëve të gjykatave respektive kërkesat për heqje dorë, të cilat janë pranuar [...].*

16.5 Komisioni ka vlerësuar se:²¹ [...] *Sjellja e subjektit të rivlerësimit, duke hequr dorë në gjithë çështjet e tjera që i caktoheshin asaj për gjykim dhe ku Avokatura e Shtetit përfaqësohej nga bashkëjetuesi i saj, tregon për dispozicionin e subjektit për të respektuar dispozitat ligjore nga i buronte ky detyrim dhe për të ruajtur të pacenuar paanësinë në gjykim dhe besimin e publikut te drejtësia... Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në këto dy çështje nuk është në asnjë nga rastet e shkeljeve disiplinore të parashikuara nga nenet 101, 102 e 103 të ligjit nr. 96/2016. Duke mbajtur parasysh këto rrethana, në përfundim Komisioni çmon se prapësimet e subjektit janë bindëse dhe nuk konstatohen mangësi në dy çështjet që i janë caktuar asaj për gjykim [...].*

16.6 **Komisioneri Publik**, bazuar në aktet e administruara në dosje dhe në jurisprudencën e Kolegjit, lidhur me qëndrimin e subjekteve mbi rastet e konfliktit të interesit, dhe nivelin e duhur të dilijencës që nevojitet për ushtrimin e funksionit si gjyqtar²², ndan qëndrim të ndryshëm nga vlerësimi që ka bërë Komisioni, pasi konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar kujdesin e duhur për të vlerësuar me objektivitet, mundësinë e dorëheqjes nga këto procese për të shmangur çdo dyshim për paanësinë e saj në gjykimin e tyre, por edhe të garantimit të perceptimit të publikut se drejtësia, jo vetëm po jepej, por edhe të dukej se po jepej.

16.6.1 Në këto rrethana vlerësojmë se është i bazuar konstatimi fillestar i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit, në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore me palë të tretë Avokatura e Shtetit, për periudhën kur ka qenë drejtues bashkëjetuesi i saj, ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, që, për efekt të procesit të rivlerësimit, trajtohen brenda indikatorit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, sipas parashikimit të nenit 75, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2016, dhe së bashku me gjetjet e tjera, duhet të merren në konsideratë në vlerësim tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

17. Lidhur me gjetjet në raportin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ dhe denoncimet nga publiku. Referuar rezultateve të hetimit administrativ mbi këto akte, **Komisioneri Publik** çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, si dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, mbi gjetjet e rezultuara nga burimet e administruara, të cilat duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, së bashku me shkaqet e tjera të ankimit, për sa në vijim:

²¹ Referohuni prg. 50-52, faqe 86, të vendimit të Komisionit.

²² Referohuni vendimit (JR) nr.15/2021, si dhe vendimit (JR) nr. 53/2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

18. Komisioni ka analizuar dokumentacionin e depozituar nga KLGJ-ja, mbi të cilin është hartuar Raporti i vlerësimit profesional nr. ***/* prot., datë **.2.2022, për subjektin e rivlerësimit. Lidhur me gjetjet në Raportin e KLGJ-së, ndër të tjera, subjektit i ka kaluar barra e provës, për sa vijon:

18.1 **Dosja nr. * - Vendim nr. ***, datë **.7.2016, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë, me objekt: “Deklarim ikje”, të shtetasit *** ***, dyshuar për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal**

18.1.1 Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Korçë, në datën **.7.2016, dhe i është caktuar subjektit të rivlerësimit, znj. Sonjela Voskopi, e cila ka caktuar zhvillimin e seancës gjyqësore në po të njëjtën ditë, në datën **.7.2016, ora 11.30. Me vendimin nr.***, datë **.7.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: “Deklarimin e ikjes” të shtetasit *** *** dhe caktimin e një avokati kryesisht për këtë shtetas.

18.1.2 Në raportin e KLGJ-së është konstatuar se dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar është dorëzuar nga gjyqtarja në datën **.12.2016, **4 muaj e 16 ditë pas shpalljes së vendimit** dhe jashtë afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Pr. Penale. Sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

18.1.3 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Pra, theksoj se vendimi gjyqësor *** regj., datë **.07.2016, është arsyetuar dhe dorëzuar organit të Prokurorisë brenda datës së seancës gjyqësore, por për shkak të karakterit sekret, dosja është depozituar në sekretari datën që Komisioni i referohet, së bashku me dosjen që i përket vendimit nr.*** regj, datë **.07.2016, “Për caktim mase sigurimi personal” [...].²³*

18.1.4 Komisioni, në lidhje me depozitimin e dosjes gjyqësore në Sekretari përtej afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale, ka vlerësuar se, në momentin që Gjykata disponon me vendim “Për deklarimin e ikjes” së të pandehurit dhe cakton avokat kryesisht për t’u njohur me veprimet procedurale të organit të akuzës dhe për të realizuar mbrojtjen e të pandehurit të deklaruar “i ikur”, atëherë masa e sigurimit “Arrest në burg” e ka humbur karakterin “sekret” dhe parandalues të ikjes së të pandehurit, pasi tashmë i pandehuri i ka ikur hetimit/gjykimit. Në përfundim, Komisioni i ka qëndruar konstatimit të tij se depozitimi i vendimeve në Sekretari **4 muaj e 16 ditë** pas shpalljes së tyre është bërë nga subjekti në tejkalim të afatit 5-ditor, të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale, por ka vlerësuar se kjo mangësi nuk është e një rëndësie të tillë, sa ndaj subjektit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për mangësi profesionale.

18.1.5 **Komisioneri Publik** vlerëson se kjo mangësi, së bashku me gjetjet e tjera të Raportit të KLGJ-së²⁴, duhet të vlerësohet në kuptim të nenit 4, pika 2 të ligjit nr.84/2016, në vlerësim tërësor të çështjes.

19. **Denoncimet nr. ***, datë **.6.2019 dhe nr. ***, datë **.3.2021**, nga shtetase ***²⁵, e cila ngre pretendime lidhur me çështjen civile nr.***, gjykuar nga subjekti i

²³ Referohuni më gjerësisht shpjegimeve të subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit, si dhe vendimit të Komisionit.

²⁴ Nga raporti i KLGJ-së rezulton se subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjykimin jashtë afatit të përcaktuar nga Aneksi 1 i Sistemit të Vlerësimit, për dy nga tre dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe 3 nga pesë dosjet e shortuara.

²⁵ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë ka informuar Komisionin se kjo Prokurori i ka kaluar për kompetencë tokësore Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Pogradec, kallëzimin penal

rivlerësimit. Bashkëlidhur denoncimeve janë: vendimi nr. ** prot., datë **.7.2019, i Gjykatës së Rrethit Korçë, për pranimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës Sonjela Voskopi nga gjykimi i çështjes; vendimi nr.***, datë **.11.2019, i Gjykatës së Rrethit Korçë, për gjykimin e çështjes civile nr.***, nga gjyqtare *** ***, e cila gjykoi çështjen pas përjashtimit të subjektit të rivlerësimit; vendimi nr. **-2020-***, datë **.11.2020, i Gjykatës së Lartë.

19.1 Nga aktet bashkëlidhur denoncimit, ndër të tjera, ka rezultuar se paditësi ***. ***, me datë **.6.2019, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë, me padi me objekt: “Njohje pronar mbi një send të paluajtshëm, sipas nenit 175 të Kodit Civil, kundrejt palëve të paditura *** *** etj.”. Bashkë me padinë, paditësi ka kërkuar edhe marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke vendosur sekuestro konservative për pasurinë objekt gjykimi për të mos lejuar tjetërsimin te të tretët.

19.2 Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e ndërmjetëm nr.***, datë **.6.2019, në seancë përgatitore, ka vendosur masën e sigurimit të padisë, duke bllokuar pranë ASHK Drejtoria Vendore Korçë regjistrimin e çdo veprimi juridik tjetërsimi në lidhje me pronën objekt gjykimi deri në gjykimin e padisë me vendim gjyqësor të formës së prerë.

19.3 Më pas, gjykimi ka vijuar nga një tjetër gjyqtar, sepse subjekti i rivlerësimit, me vendimin gjyqësor nr. ** prot., datë **.7.2019, është përjashtuar nga gjykimi sipas kërkesës së denoncueses, me qëllim që të mos paragjykohej kallëzimi penal që denoncuesja kishte bërë ndaj subjektit të rivlerësimit për këtë gjykim²⁶.

19.4 Kundër vendimit të ndërmjetëm nr.***, datë **.6.2019, të subjektit të rivlerësimit, pala e paditur (*** ***, *** ***, *** ***, *** ***) ((***)), ka bërë ankim, duke kërkuar ndryshimin e vendimit, rrëzimin e kërkesës së palës paditëse dhe heqjen e masës së sigurimit të padisë.

19.5 Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. **, datë **.7.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimin nr.***, datë **.6.2019, të subjektit të rivlerësimit.

19.6 Mbi bazën e rekursit të paraqitur nga pala e paditur, shtetasja ***. ***, çështja është gjykuar në Gjykatën e Lartë, e cila ka disponuar me vendimin nr.***, datë **.11.2020, duke prishur vendimin [...] nr.**, datë **.7.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe vendimit datë **.06.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë dhe rrëzimin e kërkesës së paditësit *** ***, për sigurimin e padisë [...], duke arsyetuar, ndër të tjera, se: [...] Në lidhje me ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave më të ulëta mbi sigurimin e padisë, Kolegji vlerëson se gjykatat më të ulëta kanë keqzbatuar ligjin procedural mbi marrjen e masës së sigurimit të padisë, çka e bën të cenueshëm vendimin e tyre... Kolegji vlerëson se, ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit, sigurimi i padisë nuk garanton ekzistencën e së drejtës në kuptimin juridik, por material. Qëllimi i synuar nga pala në rastin konkret arrihet nëpërmjet regjistrimit të padisë sipas nenit 197/b të Kodit Civil, i cili ka parashikuar se duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme kërkesëpaditë për fitimin, njohjen,

nr.***/2019 të shtetasës *** ***, ndaj subjektit të rivlerësimit për veprën penale “Shpërdorim detyre”, për të cilin Prokuroria e Pogradecit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

²⁶ Kallëzimin penal nr. ***/2019 të shtetasës *** ***, ndaj subjektit të rivlerësimit për veprën penale “Shpërdorim detyre”, për të cilin Prokuroria e Pogradecit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Referuar dosjes penale për kallëzimin ndaj subjektit dhe dosjes gjyqësore të gjykimit që ka kryer subjekti, të administruara këto nga Komisioni me shkresën ***, datë **.9.2023, rezulton se me vendimin datë **.7.2019, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka vendosur mosfillimin e procedimit për këtë kallëzim, pasi fakti nuk përbën veprën penale.

ndryshimin ose pushimin e të drejtave të pronësisë ose të drejtave të tjera reale mbi pasuritë e paluajtshme. Regjistrimi i padisë nuk mbron palët, por mbron të tretët që kryejnë veprime juridike në lidhje me atë send, për shkak se, sipas neneve 451/a dhe 200 të KPC, vendimi gjyqësor është i detyrueshëm, jo vetëm për palën, por edhe për personat që kanë fituar të drejta nga palët gjatë gjykimit. ... **Kolegji vlerëson se kjo vendimmarrje e gjykatave më të ulëta përbën kufizim pa ligj dhe në mënyrë të pajustificuar, të së drejtës së pronës së palës paditur. Ky interpretim i gabuar i ligjit nga gjykatat nuk është në pajtim me nenet 11 dhe 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim: KEDNJ) [...].**

19.7 Sa më sipër, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi, referuar dispozitave ligjore dhe vendimit të Gjykatës së Lartë, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për sigurimin e padisë, në kundërshtim me nenin 202 e vijues K. Pr. Civile.

19.8 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegime të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...]Vendimi gjyqësor, datë **.06.2019, 'Për sigurimin e padisë' nuk është dhënë në kundërshtim më ndonjë vendim unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që të ketë interpretuar në mënyrë detyruese për zbatim nenin 203 të K. Pr. Civile, apo nenin 206 të Kodit të Procedurës Civile në raport me nenin 197, germa b) të K. Civil; as në kundërshtim me ndonjë vendim njësues të praktikës gjyqësore i nxjerrë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga 5 gjyqtarë; as në kundërshtim me ndonjë vendimmarrje të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që të ketë ndryshuar praktikën e unifikuar/njësuar më parë...Vendimi nr.***, datë **.11.2020, i Gjykatës së Lartë, që ka gjetur interpretim të gabuar të ligjit procedural civil në vendimmarrjen time dhe në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, respektohet nga ana ime si i dhënë nga një gjykatë më e lartë, por duke mos qenë vendim unifikues ose njësues për praktikën gjyqësore nuk është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha gjykatat në çështje të ngjashme, por është i detyrueshëm vetëm për rastin në shqyrtim [...].

19.9 Komisioni, në përfundim, ka arsyetuar²⁷ se subjekti i rivlerësimit ka dhënë argumente bindëse në lidhje me caktimin e masës së sigurimit të padisë, rëndësinë dhe pasojat e kësaj mase. Duke mbajtur parasysh të gjitha këto shpjegime, faktin që vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është unifikues, por as detyrues për rastin konkret (sepse çështja nuk është rikthyer për gjykim, por është rrëzuar padia nga Gjykata e Lartë), si dhe faktin që Gjykata e Lartë në vendimin e saj nuk i referohet ndonjë vendimi unifikues për raste të ngjashme, atëherë Komisioni vlerëson se qëndron plotësisht masa e sigurimit të padisë që ka dhënë subjekti. Subjekti nuk ka treguar mosnjohje apo moszbatim të ligjit, por i ka interpretuar ato, si dhe në përputhje me rrethanat e çështjes dhe pozitën juridike të palëve. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se nuk konstatohen mangësi në veprimet e subjektit.

19.10 **Komisioneri Publik**, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, nuk provoi të kundërtën e barrës së provës. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit si dhe qëndrimi i Komisionit që Gjykata e Lartë, në arsyetimin e saj: [...] nuk i referohet ndonjë vendimi unifikues për raste të ngjashme, atëherë vlerëson se qëndron plotësisht masa e sigurimit të padisë që ka dhënë subjekti [...], duket se nuk është bindës, dhe në vlerësimin e Komisionerit Publik duket se nuk mban në konsideratë pozicionin e Gjykatës së Lartë në hierarkinë kontrolluese gjyqësore, duke shqyrtuar e zgjidhur çështje të lidhura me kuptimin

²⁷ Referohuni prg. 32.13, faqe 79, të vendimit të Komisionit.

dhe zbatimin e ligjit, jo vetëm për të siguruar njësimin e praktikës, por dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit²⁸.

20. Denoncimi nr. *, datë **.10.2018**, nga shtetasja *** ** (***), që pretendon se subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit, as nuk e ka orientuar për rregullimin e ndërgjyqësisë, të cilën denoncuesja nuk e kishte bërë në mënyrën e duhur, as nuk i ka dhënë 5 ditë afat për plotësimin e kërkesëpadisë, por e rrëzoi padinë pa gjykim në themel (vendim nr. ***, datë ***.2.2012). Bashkëlidhur denoncimit janë disa akte që provojnë zhvillimin e këtyre proceseve gjyqësore, si dhe provat e paraqitura gjatë tyre.

20.1 Në datën **.7.2011, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë, është regjistruar padia me Paditës - *** **; Të paditur - *** dhe *** **; Objekt 1) Detyrimin e të paditurit ta njohë trashëgimtarë ligjore dhe t'i dorëzojë 1/5 e pasurisë trashëgimore; 2) Pavlefshmërinë absolute të testamentit nr. **, datë **.5.1995; 3) Marrjen e masës së sigurimit të pasurisë trashëgimore etj.

20.2 Me vendimin nr. ***, datë **.2.2012, subjekti i rivlerësimit ka rrëzuar padinë e ngritur nga *** ** (***). Në vendimin e saj, subjekti arsyeton se, duke qenë se paditësja nuk ka ndërtuar drejt ndërgjyqësinë, sepse nuk ka thirrur si të paditur të gjithë trashëgimtarët testamentarë të babait të saj *** ** **, atëherë ndërtimi i drejtë i ndërgjyqësisë nuk mund të kryhet kryesisht nga gjykata, e cila kështu nuk mund të shprehet për themelin e çështjes, por për rrëzimin e padisë. Vendimi i subjektit të rivlerësimit është ankimuar nga paditësja dhe Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. ***, datë **.6.2012, e ka lënë në fuqi vendimin e subjektit të rivlerësimit.

20.3 Mbi rekursin e ushtruar nga paditësja, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë **.10.2015, ka vendosur prishjen e vendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të Gjykatës së Apelit Korçë. Në vendimin e saj, Gjykata e Lartë argumenton se vendimet e dy gjykatave të faktit [...] janë marrë në interpretim e zbatim të gabuar të ligjit procedural, duke lejuar shkelje të dispozitave ligjore procedurale, që kanë të bëjnë me ndërtimin e drejtë të ndërgjyqësisë dhe identifikimin e saktë të pozitës procedurale të palëve. Gjykata e Rrethit Korçë nuk ka përmbushur detyrimet procedurale për përgatitjen e çështjes për gjykim dhe kujdesin për qëndrimet që gjykata duhet të mbajë për realizimin e një gjykimi të rregullt, përfshirë edhe ndërtimin e drejtë të ndërgjyqësisë [...].

20.4 Komisioni ka arsyetuar²⁹ se, duke qenë në një linjë me vendimin e Gjykatës së Lartë, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka shkelur dispozitat procedurale midis të cilave edhe nenin 161, paragrafi 2 të K. Pr. Civile, që përcakton se: “Gjyqtari, kur konstaton se bashkëndërgjyqësia e detyrueshme në anën e të paditurve është e paplotë, i lë palës paditëse një afat deri në 20 ditë që ta rregullojë atë, sipas shkronjës “c” të këtij neni dhe nenit 154/a të këtij Kodi. Në rast se paditësi nuk vepron brenda afatit të mësipërm, gjykata vendos pushimin e gjykimit”. Për sa më lart, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi nuk ka zbatuar detyrimin procedural të gjykatës për të orientuar palët në rregullimin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme.

²⁸ Neni 141 i Kushtetutës.

²⁹ Referohuni prg. 34.7, faqe 81, të vendimit të Komisionit.

20.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Mbaj qëndrimin se ky vendim i Gjykatës së Lartë, në respektim të nenit 486 të K. Pr. Civile në fuqi në kohën e shpalljes së tij, pavarësisht se respektohet prej meje si i dhënë nga një gjykatë më e larë, ka efekt vetëm për rastin në gjykim, dhe nuk është i detyrueshëm për zbatim për gjykatat në çështje të ngjashme për sa nuk është vendim unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Mendoj se vendimi nr.***, datë **.02.2012, është dhënë prej meje jo vetëm në mbështetje të parimit të disponibilitetit mbi padinë, por dhe në zbatim të vendimit unifikues i detyrueshëm për zbatim, atij nr. ***, datë **.07.2000, sipas të cilit: “Është në disponimin e paditësit thirrja me cilësinë e të paditurit e personave të tjerë [...].*

20.6 Pasi Komisioni ka marrë në shqyrtim prapësimet e subjektit të rivlerësimit, ka vlerësuar se ato janë ligjrisht të bazuara dhe nuk konstatohen mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit.

20.7 **Komisioneri Publik**, edhe në rastin konkret, sikurse më lart arsyetuar, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk provuan të kundërtën e barrës së provës, lidhur me parashikimet ligjore procedurale për rregullimin e ndërgjyqësisë nga Gjykata. Qëndrimet e përsëritura të subjektit të rivlerësimit në raport me vendimet e Gjykatës së Lartë, në vlerësimin e Komisionerit Publik, janë rrethana që duhen vlerësuar në drejtim të indikatorëve të përcaktuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016, në drejtim të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe, së bashku me gjetjet e tjera, duhen vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësim tërësor të procedurave.

III.C - Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

21. Apartament banimi me sip.104 m², në Korçë

21.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sip.104 m² me vendndodhje në adresë: Lagjja nr. *, Rruga “*** **”, Pallati nr. **, Hyrja *, Ap. **, Korçë, mbi të cilin kam të drejtë përdorimi që e kam marrë nga babai im *** ***, i cili disponon aktmarrëveshje datë **.1.2012, me Shoqërinë e Ndërtimit (shitësi) “*** **” sh.p.k. Në vitin 2015 kam filluar bashkëjetesën, për këtë arsye kam filluar të përdor apartamentin e mësipërm. Për arredimin e banesës, gjatë viteve 2015-2016, nga kursimet e mia dhe të bashkëjetuesit, kam shpenzuar: në vitin 2015 kam shpenzuar nga kursimet e mia 1.300.000 lekë dhe 700.000 lekë nga kursimet e bashkëjetuesit. Për vitin 2016 kam shpenzuar nga kursimet e mia 400.000 lekë dhe nga kursimet e bashkëjetuesit 300.000 lekë. Vlera e arredimit gjithsej: 2.700.000 lekë. Vlera e apartamentit: 3.500.000 lekë sipas aktmarrëveshjes, nga të cilat të likuiduara 2.500.0000 lekë.*

21.2 Në D-Vett., babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sip.104 m² me vendndodhje në adresë: Lagjja nr. *, Rruga “*** **”, Pallati nr. **, Hyrja *, Ap. **, Korçë, për të cilën kam nënshkruar aktmarrëveshje, datë **.1.2012, me shoqërinë e ndërtimit (shitësi) “*** **” sh.p.k. Apartamentin ia kam lënë në përdorim vajzës sime Sonjela Voskopi. Apartamenti nuk është regjistruar në regjistrat publikë në pronësinë time për shkak të mosshlyerjes së plotë të vlerës së tij. Të ardhurat janë krijuar nga puna ime dhe e bashkëshortes (kursime të depozituara në banka para fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit), si dhe të ardhura të përfituara nga bashkëshortja me dhurim, nga shitja e pronave nga prindërit e saj. Vlera e apartamentit është 3.500.000 lekë, nga të cilat kam likuiduar 2.500.000 lekë.*

21.3 Në DV-2015, në rubrikën “Shpenzimet e deklarueshme”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shpenzime për arredimin e një banese. Banesën e kam në përdorim të drejtë përdorimi, që ma ka dhënë babai im, *** ***. Kam shpenzuar vetëm për mobilimin e banesës së bashku me bashkëjetuesin. Vlera që unë kam shpenzuar është 1.300.000 lekë. Pjesa tjetër e shpenzimeve është mbuluar nga bashkëjetuesi sipas deklaratës bashkëngjitur dhe deklaratës që ai plotëson me vete si subjekt deklarues, për shkak të pozicionit të tij të punës si Avokat Shteti pranë Zyrës Vendore Korçë. Vlera 1.300.000 lekë.*

21.4 Në DV-2015, në rubrikën “Shpenzimet e deklarueshme”, personi i lidhur, z. ***. ***, ka deklaruar: [...] *Kam shpenzuar vetëm për mobilimin e banesës së bashku me bashkëjetuesin. Vlera që unë kam shpenzuar është 700.000 lekë [...].*

21.5 Në dosje të Komisionit, lidhur me këtë apartament, ndër të tjera, janë administruar: (i) Aktmarrëveshje (pa të drejtë pronësie) datë **.1.2012, ndërmjet shoqërisë “*** ***” sh.p.k. dhe blerësit, z. *** ***, për apartamentin me sip.104 m², në rr: “*** ***”, Korçë, në vlerën 3.500.000 lekë. (ii) Mandat arkëtimi nr.**, datë **.1.2012, me anë të të cilit z. *** *** ka paguar në arkën e shoqërisë “*** ***” sh.p.k. shumën prej 1.500.000 lekë; (iii) Mandat arkëtimi nr.**, datë **.4.2013, për shumën 1.000.000 lekë; (iv) Shkresa datë **.7.2017, e shoqërisë “*** ***”, sh.p.k, drejtuar ILDKPKI-së, që konfirmon sa më sipër bashkëlidhur së cilës është dërguar certifikata e pronësisë datë **.6.2015, lëshuar nga ZVRPP Korçë, ku apartamenti me sip.104 m² figuron i regjistruar në pronësi të kësaj shoqërie; (v) ZVRPP Korçë nuk konfirmon³⁰ pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetuesit të saj; (vi) “*** ***” sh.a. konfirmon se ekziston një kliente me emrin Sonjela Voskopi, e regjistruar prej muajit gusht të vitit 2015, në adresën Korçë, Lagjja *, Rr. “*** ***”³¹; (vii) *** konfirmon se kontrata nr. *-*** në instancën Korçë i përket abonentit *** **, e cila është hapur më datë **.11.2014³².

21.6 Komisioni, lidhur me çmimin e blerjes së këtij apartamenti nga babai i subjektit të rivlerësimit, ka vërejtur se, referuar çmimit të EKB-së në vitin 2012 (51,500 lekë/m²), vlera e apartamentit duhej të ishte 5.356.000 lekë dhe jo 3.500.000 lekë. Pra, duket se apartamenti me vlerë 3.500.000 lekë është blerë rreth 1.800.000 lekë më lirë sesa çmimi i referencës.

21.7 Komisioni, në përfundim të hetimit, referuar faktit që për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 104 m² nuk është paguar diferenca prej 1.000.000 lekë e çmimit të blerjes; faktit që vlera e kontraktuar është 1.800.000 lekë më e ulët se çmimi referencë; faktit që kjo pasuri është përdorur nga subjekti që nga viti 2015 e deri më sot (e provuar kjo edhe me kontratat e furnizimit me ujë e lidhur në emër të subjektit) dhe me energji elektrike (e lidhur në emër të vëllait të subjektit), Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës si vijon: (i) *Të shpjegojë dhe provojë në mënyrë bindëse përse nuk është bërë deri sot pagesa e diferencës së çmimit prej 1,000,000 lekë; (ii) Të justifikojë diferencën midis çmimit të ulët të paguar të apartamentit dhe çmimit referencë; (iii) Të provojë çmimin real të apartamentit duke depozituar kontrata të ngjashme të porosisë dhe shitjes së apartamenteve nga shoqëria “*** ***” sh.p.k. në pallatin ku është ndërtuar ky apartament;*

³⁰ Shkresa nr. ***/**, datë **.10.2017, e ZVRPP-së Korçë, drejtuar ILDKPKI-së.

³¹ Me shkresën nr. ***/**, datë **.10.2023, drejtuar Komisionit.

³² Me shkresën nr. ***/**, datë **.10.2023, të FSHU-së.

(iv) Të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5, të aneksit të Kushtetutës.

21.8 **Lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e apartamentit**, në Deklaratën “Vetting”, babai i subjektit të rivlerësimit si burime të ardhurash për blerjen e apartamentit ka deklaruar: (i) Të ardhurat e krijuara nga puna e tij dhe e bashkëshortes (kursime të depozituara në banka para fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit); (ii) të ardhura të përfituara nga bashkëshortja me dhurim, nga shitja e pronave nga prindërit e saj.

21.9 Komisioni ka kryer analizën financiare mbi mundësinë financiare të prindërve të subjektit për të krijuar shumën prej 2,500,000 lekë, të paguar për blerjen e apartamentit. Nga analiza financiare, e kryer për periudhën 1993-2006³³, ka rezultuar se prindërit e subjektit nuk kanë pasur pjesërisht të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e likuiditeteve që kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2011, për një diferencë negative në vlerën - 955,821.

21.10 Për sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se: (i) *Duket se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur një mungesë fondesh në shumën – 955.821 lekë për të krijuar kursimet e tyre deri në vitin 2006, të cilat kanë shërbyer për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi;* (ii) *Referuar deklaramit të subjektit gjatë hetimit administrativ, se shuma totale 1,500,000 lekë, e tërhequr nga bankat, në shkurt të vitit 2009, është mbajtur cash në banesë, krijohet dyshimi i arsyeshëm që kjo shumë të mos jetë pjesë përbërëse e shumës 3,000,000 lekë, të depozituar në janar të vitit 2011;* (iii) *Bazuar në këtë dyshim, arsyetohet se, nëse shuma 3,000,000 lekë do të konsiderohej si një shtesë likuiditeti pjesërisht e re³⁴, atëherë konkluzionit të Komisionit për pamundësi financiare të prindërve të subjektit në vlerën -955.821 lekë, për periudhën 1993 – 2006, e cila është pothuajse sa vlera e gjendjes cash të krijuar dhe deklaruar nga prindërit në DIPP-në e vitit 2008, do t’i shtohet pamundësia e familjes për të krijuar një shumë të re prej 1.500.000 lekësh në vitin 2011. Kështu, pamundësia e subjektit dhe e familjes së saj për të krijuar likuiditete, të cilat kanë shërbyer si burim për pagesat e apartamentit në janar 2012 dhe në prill 2013, do të ishte e barabartë me vlerën e paguar të apartamentit. Në këtë rast do të konkludohej që duket se familja e subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kryer pagesat e apartamentit.*

21.11 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës që të provojë bindshëm dhe qartë burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës prej 3.000.000 lekësh, të çelur nëpërmjet veprimit *depozitim cash*, në datën **.1.2011, në *** Bank.

21.12 **Lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave për mobilimin e apartamentit**, në Deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar se për mobilimin e apartamentit ka shpenzuar: (i) gjatë vitit 2015, vlerat 1.300.000 lekë nga kursimet e saj dhe 700.000 lekë nga kursimet e bashkëjetuesit; (ii) gjatë vitit 2016, vlerat 400.000 lekë nga kursimet e saj dhe 300.000 lekë nga kursimet e bashkëjetuesit.

³³ Komisioni referon se analiza është kryer bazuar në metodologjinë kumulative, pasi i takon periudhës para emërimit në detyrë të subjektit. Ajo fillon nga viti 1993, kur prindërit e subjektit kanë filluar të përfitojnë të ardhura dhe të krijojnë pasurinë e tyre dhe shtrihet deri në zanafillën e krijimit të likuiditeteve, në fund të vitit 2006.

³⁴ Pasi shuma *cash* prej 1.000.000 lekë, që vjen nga DIPP e vitit 2008, konsiderohet i mbajtur *cash* në vijimësi sipas shpjegimeve të subjektit.

21.13 Komisioni ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të shpenzimeve të mobilimit për vitet 2015 dhe 2016. Nga analiza financiare e vitit 2015, në të cilën janë përfshirë vetëm subjekti dhe bashkëjetuesi i saj, ka rezultuar se në këtë vit ata nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e këtyre kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, për shkak të një balancë negative në vlerën - 533,919 lekë. Në këtë analizë nuk është përfshirë dhurata e bashkëjetuesit nga prindërit e tij në vlerën 500.000 lekë, pasi subjekti nuk ka mundur të provojë me dokumentacion të ardhura nga toka bujqësore e prindërve të bashkëjetuesit, por është kryer reduktimi i shpenzimeve të jetesës të bashkëjetuesve.

21.14 Në përfundim të sa më sipër, Komisioni, pasi ka konstatuar se duket se çifti nuk ka pasur mundësi të krijojë shumën prej 700.000 lekësh për mobilim në vitin 2015, deklaruar si pjesëmarrje e bashkëjetuesit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, që të provojë të kundërtën e konstatimit.

21.15 Komisioni, në përfundim pasi ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit³⁵ pas kalimit të barrës së provës, ka arsyetuar për secilën nga konstatimet e mësipërme dhe, ndër të tjera, ka vlerësuar³⁶ se: [...] pretendimi i subjektit se nuk duhen lënë jashtë analizës financiare vitet 2007 e 2008, kur familja ka vazhduar t'i krijojë kursimet cash me burime të ligjshme, qëndron. Për këtë arsye është kryer analiza financiare e rishikuar për periudhën 1993 deri në fund të vitit 2008, duke përdorur metodologjinë kumulative. Nga kjo analizë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj kanë pasur mundësi për të krijuar shumën 2,500,000 lekë në banka dhe cash, deri në fund të vitit 2008, për shkak të një balance pozitive në vlerën 54,711 lekë ... Në lidhje me prapësimet e subjektit ndaj pamundësisë financiare në shumën -533,191 lekë, rezultuar në vitin 2015, Komisioni vlerëson që të marrë parasysh kërkesën e subjektit për të konsideruar si të ardhura të ligjshme dhuratën prej 500,000 lekësh nga prindërit e bashkëjetuesit e, si të tillë, ta përfshijë atë në analizën financiare. Po ashtu, për shkak se reduktimi i shpenzimeve të jetesës me përqindjen që zë shporta e konsumit ushqimor në shpenzimet e jetesës ishte bërë për shkak të njohjes së përfitimit në natyrë të produkteve bujqësore nga ana e çiftit, ky reduktim nuk do të jetë më i vlefshëm dhe shpenzimet e jetesës do të konsiderohen sipas standardit të ILDKPKI-së. Sipas analizës së rishikuar të Komisionit, rezultati financiar i vitit 2015 nga -533,191 lekë bëhet -252,363 lekë ... Në përfundim, në lidhje me pasurinë apartament me sip. 104 m², me vendndodhje në Korçë, subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e saj kanë pasur mundësi që, me burime të ligjshme, të paguajnë shumën 2,500,000 lekë, për blerjen e tij, por nuk kanë pasur mundësi që për mobilimin e tij në vitin 2015 të krijojnë shumën 700,000 lekë, për shkak të balancës negative prej -252,363 lekësh. Duke mbajtur në konsideratë, së pari, pikërisht mundësinë financiare për blerjen e këtij apartamenti, ku kontributi më i madh financiar është ai i prindërve; së dyti, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti gjatë hetimit dhe në prapësime, të cilat provuan se apartamenti është blerë me vlerë më të lartë sesa çmimi referencë dhe është toleruar në pagimin e kështit të mbetur prej 1,000,000 lekësh të çmimit të apartamentit, pikërisht për shkak të marrëdhënieve të ngushta familjare dhe marrëdhënieve të punës midis familjarëve të subjektit e shoqërisë që i ka shitur apartamentin, të ndërtuara këto

³⁵ Subjekti i rivlerësimit, në aktin "Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ", ka dhënë shpjegime lidhur me konstatimet e mësipërme të Komisionit.

³⁶ Referohuni arsyetimit të Komisionit f. 10-12, 21-26 dhe f. 28-29 të vendimit.

marrëdhënie në terrenin tradicional shqiptar, si dhe për shkak të politikës së aktivitetit të kësaj shoqërie me të gjithë blerësit, krijohet bindja e plotë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ky apartament nuk është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit [...].

21.16 Komisioneri Publik, referuar akteve të administruara në dosje, ndryshe nga sa ka konstatuar Komisioni, vëren se edhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 104 m² që është dukshëm më i ulët se çmimi sipas EKB-së, përsëri rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesat e kryera për këtë apartament dhe shpenzimet e mobilimit të kryera në vitin 2015, për sa vijon:

21.16.1 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, për periudhën 1993 - 2008, vërejmë se shpenzimet e jetesës për vitin 2007³⁷, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk janë llogaritur sipas standardit tashmë të konsoliduar të Kolegjit, në shumën 235.968 lekë për secilin anëtar të familjes. Si rezultat, duke llogaritur shpenzimet e jetesës për vitin 2007 sipas standardit, subjekti dhe personat e lidhur me të rezultojnë me një pamjaftueshmëri financiare për këtë periudhë në vlerën -342.681 lekë.

21.16.2 Lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të shpenzimeve të mobilimit për vitin 2015, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk arritën të provojnë të kundërtën lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit për shumën 500.000 lekë, e deklaruar nga personi i lidhur (bashkëjetuesi) si e ardhur nga toka bujqësore dhe, si rezultat, këto të ardhura nuk duhen përfshirë në analizën financiare. Gjithashtu, në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e jetesës edhe për këtë vit duhen llogaritur sipas standardit të ILDKPKI/INSTAT, të aplikuar për të gjithë subjektet e rivlerësimit³⁸.

21.16.3 Sa më sipër arsyetuar rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet e mobilimit të deklaruara në vitin 2015 dhe kursimet e deklaruara për një diferencë negative prej – 752.363 lekësh.

21.17 Duke përfunduar lidhur me pasurinë “Apartament banimi me sip.104 m², në Korçë”, Komisioneri Publik vlerëson se këto pamjaftueshmëri, në varësi edhe të rezultateve të hetimit të kërkuar nëpërmjet shkaqeve të këtij ankimi, mund të ndikojnë në vlerësimin përfundimtar për subjektin e rivlerësimit, në këndvështrim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

22. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik nuk vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

23. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje

³⁷ Referohuni analizës financiare të Komisionit në f. 55-56 të vendimit dhe analizës financiare në dosje të Komisionit.

³⁸ Referuar të dhënave të ILDKPKI/INSTAT, shpenzimet e jetesës për vitin 2015 janë në shumën 224.276 lekë/person.

me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

24. Duke nënvizuar nevojën që provat e administruara të arrijnë nivelin e provueshmërisë në drejtim të nivelit të besueshmërisë për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit;

25. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2, dhe nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016;

26. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, të çelë hetimin gjyqësor dhe, në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 768, datë 31.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ose
- Ndryshimin e këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA